




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 160, datë 19.2.2020

P Ë R

**MBËSHTETJEN FINANCIARE TË STUDENTËVE TË SHKËLQYER  
DHE TË NËPUNËSVE CIVILË (FONDI I EKSELENCËS)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 4, dhe 112, pika 4, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Financimin nga buxheti i shtetit, brenda fondeve buxhetore të miratuara për vitin përkatës për Fondin e Ekselencës, dhe nga donacione ose të ardhura të tjera, nga burime të ligjshme, për mbështetjen financiare të studentëve shqiptarë të shkëlqyer, i cili përdoret nga ministria përgjegjëse për arsimin për bursa për:
  - a) studentët, të cilët ndjekin studimet e ciklit të dytë apo të tretë jashtë vendit, në universitetet më të mira të botës;
  - b) nëpunësit civilë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
2. Nga fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përfitojnë mbështetje financiare kandidatët që plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon:

